



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 905 Prot.

Tiranë, më 07.03.2024

Lënda: Kërkesë për deklarimin e pavlefshmërisë/anullimin e votimeve të kryera në seancën plenare të datës 07.03.2024.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Për dijeni: SH.T.Z. Bajram BEGAJ
President i Republikës

E nderuar Znj. Kryetare e Kuvendit,
Të nderuar anëtarë të Sekretariatit,

Në rendin e ditës të seancës plenare të datës 07.03.2024, ishin të përfshira për shqyrtim 4 projektligje, përkatësisht:

- a) projektligji “Për burimet ujore”,
- b) projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015 “Për Turizimin”, të ndryshuar,
- c) projektligji “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe
- d) projektligji “Për një ndryshim në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar”.

Me propozim të deputetes Evis Kushi dhe kërkesë të kryetarit të Grupit Parlamentar të PS-së, është përfshirë në rendin e ditës edhe projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”.

Nga verifikimi i kryer nga drejtuesja e seancës për numrin e deputetë të pranishëm kanë rezultuar **68 deputetë**, të cilët kanë marrë pjesë në votimin për prezencën dhe

më pas për votimine pesë projektligjeve të sipërcituara. Nga ana ime si deputet dhe kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së, është ngritur në mënyrë të përsëritur mungesa e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje, çka i bënte votimet e kryera për pesë projektligjet absolutisht të pavlefshme.

Konkretisht, neni 78, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: *“Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.”*

Në interpretim të kësaj dispozite, Gjykata Kushtetuese është shprehur: *“Numri i anëtarëve të pranishëm për zhvillimin e procedurave vendimmarrëse është të paktën gjysma plus një e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, pra 71 deputetë. Rritja e pranisë në procesin e votimit mbi kuorumin e domosdoshëm sjell rritje të numrit të anëtarëve që votojnë. Vendimi i Kuvendit konsiderohet i miratuar kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm.”* (shih vendimin nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Më tej, duke elaboruar qëndrimin e saj, Gjykata është shprehur se: *“Gjykata konfirmon qëndrimin e saj se për përcaktimin e kuorumit në një proces votimi duhet t’i referohemi vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar dhe jo numrit të përgjithshëm të deputetëve që ndodhen në sallë dhe që nuk votojnë. Gjykata çmon se një deputet që nuk shpreh vullnet me votën e tij dhe si rrjedhojë nuk ndikon në procesin e votimit në Kuvend nuk duhet të llogaritet në konceptin “shumicë e të pranishmëve” për efekt të kuorumit të votimit. Nëse do të pranoni të kundërtën, atëherë do të prodhohej një rritje artificiale dhe e pajustificuar e kuorumit, gjë e cila nuk është në përputhje me qëllimin e ligjvënësit.”* (shih vendimin nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

Në zbatim të Kushtetutës, dhe vendimeve të sipërcituara të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 85, datë 18.07.2019, ka ndryshuar nenin 55 të Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon se: **“2. Kuorumi për çeljen e votimit parlamentar është të paktën 71 deputetë. 4. Për përcaktimin e kuorumit dhe të shumicës së deputetëve, sipas parashikimit të pikës 3 të këtij neni, Kryetari i Kuvendit i referohet vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar.”** Pra, për vlefshmërinë e një procesi votimi kërkohet jo vetëm që 71 deputetë të jenë të pranishëm në sallë, por 71 deputetë të marrin pjesë efektivisht në votim. Në të kundërt, siç është shprehur Gjykata Kushtetuese, një deputet që nuk merr pjesë në

votim, nuk mund të përlogaritet për efekt të kuorumit. Ky është qëllimi që neni 56 i Rregullores parashikon detyrimin e Kryetarit të Kuvendit për të verifikuar kuorumin e nevojshëm përpara çdo votimi dhe në rast se kuorumi mungon, Kryetari e shtyn votimin ose e anulon atë.

Në rastin konkret, për të pesë projektligjet e votuara, numri i deputetëve që kanë marrë pjesë në votim ka qenë më i ulët se kuorumi minimal i kërkuar nga neni 78, pika 1, e Kushtetutës së Shqipërisë, dhe neni 55, pika 2, e Rregullores së Kuvendit. Ky pretendim është ngritur në seancë në mënyrë të përsëritur nga ana ime, por çuditërisht nuk është marrë në konsideratë, çka i bën shkeljet e kryera me dashje të plotë. Në rast kur votimi kryhet në kundërshtim me Kushtetutën ose Rregulloren e Kuvendit, neni 61 parashikon se ai është i pavlefshëm, e për rrjedhojë Kryetarja e Kuvendit, pasi merr mendimin e Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet, urdhëron anulimin e votimit dhe përsëritjen e tij. Qëllimisht për shkak të mungesës së kuorumit, drejtuesja e seancës nuk shpalli në asnjë rast numrin e votave për secilin votim dhe as rezultatin e përmbledhur të këtij votimi.

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, nenit 55, pika 2 dhe nenit 61, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj deklarimin e pavlefshmërisë/anulimin e votimeve të kryera në seancën plenare të datës 07.03.2024, për shkak të mungesës së kuorumit.

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
KRYETARI**

Gazment BARDHI

